



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER JULIAN ZHELEGU
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr.
Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr.
2
TEL: 0682027818

REVOKIM AKTESH E TË TJERA

(ZGJIDHJE KONTRATE)

Nr. repertori: 4680

Nr. koleksioni: 1413

Tirane më 28/05/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notcrinë"



A2021053950099895601



AKSA E PULLES
U PAGUA



A2021053950099895601

AKT-MARREVESHJE ZGJIDHJE KONTRATE

Sot, më datë 28.5 2021, përpara meje Julian Zhelegu, Noter, me zyrë në adresën Rr. "Pjeter Bogdani", nr. 13, K. I, Tiranë, Shqipëri, lidhet kjo Akt-Marreveshje Zgjidhje Kontrate (në vijim "Akt-Marreveshja"), nga dhe ndërmjet:

Aleksander Ganolli, shtetas shqiptar, i biri i Robert dhe Valbona, lindur më 18/08/1997 në Miras, Devoll dhe banues në Tiranë, me adresë Dervish Hima; Nd. 10; H. 6; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; 0000; Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 032757134 dhe nr. personal J708180330, (ne vijim referuar si "Shitësi")

dhe

Martin Aliko, shtetas shqiptar, i biri i Fiqri dhe Margarita, lindur më 02/08/1980 dhe banues në Gjirokastër, me adresë L 11 Janari; Nd. 090; Gjirokastër; madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 028371207 dhe nr. personal I00802078R, dhe Neritan Kadhe, shtetas shqiptar, i biri i Tomor dhe Vitori, lindur më 31/01/1982 në Fier dhe banues në Korçë, me adresë L.17 Rr. Bajazit Rehova; Nd. Nr.4; Korçë; madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 036170149 dhe nr. personal I20131080R, (në vijim referuar bashkërisht si "Blerësi").

Unë, Noteri, pas shqyrtimit të dokumenteve të paraqitura nga Palët, vërtetoj se Palët janë të një moshe madhore, me zotësi të plote juridike për të vepruar. Me vullnetin e tyre te lirë, Palët kanë kërkuar dhe kanë rënë dakord për të lidhur këtë Akt sipas kushteve të mëposhtme:

MEQENESE:

- (A) Ndërmjet Shitësit dhe Blerësit është lidhur Kontrata e Shitjes së Kuotes me nr. 1233 rep, nr. 356 kol, date 12.2.2021 e Noter Julian Zhelegu (në vijim "Kontrata"), për shitjen dhe blerjen e 100% të kuotave të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "Tirana Turizem" shpk. (ne vijim "Shoqëria"), shoqëri tregtare me përgjegjësi te kufizuar, e krijuar e qe funksionon ne përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare te Biznesit me Numër Unik Identifikimi NUIS L81529022E dhe me seli ne Tirane, Njesia Administrative nr. 5, Rruga Pjeter Bogdani, nr. 5, kapitali themeltar i regjistruar i te cilës është ne shumen ALL 100.000 (njëqind mijë Lekë), sikurse rezulton nga Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
- (B) Kontrata nuk është përmbushur lidhur me pagimin e çmimit te shitjes se kuotës se shoqërisë dhe Palët kane diskutuar e kane rënë dakord për prishjen dhe zgjidhjen e Kontratës duke lidhur këtë Akt-Marreveshje për zgjidhjen e Kontratës dhe rregullimin e pasojave juridike të zgjidhjes.

PALET VENDOSEN si më poshtë vijon:



A2021053950099895601

1. Me anë të kësaj Akt-Marrëveshjeje Palët ne marrëveshje bien dakord të konsiderojnë të prishur / zgjidhur Kontratën e Shitjes së Kuotes me nr. 1233 rep, nr. 356 kol, date 12.2.2021 e Noter Julian Zhelegu, duke e lënë atë pa pasoja dhe efekte juridike, dhe Palët bien dakord se nuk ka vend për shpërblimin e ndonjë dëmi apo për pretendime të tjera ndërmjet tyre. Me lidhjen e kësaj Akt-Marrëveshjeje Palet lirohen tërësisht nga çdo detyrim dhe përjashtojnë reciprokisht përgjegjësinë e tyre për përmbushjen dhe/ose zgjidhjen e Kontrates.
2. Palet bien dakord që zgjidhja e kontrates t'i ktheje ata ne gjendjen e mëparshme duke mos pasur asnjë të drejtë dhe/ose pretendim të asnjë lloji kundrejt njera-tjetres.
3. Palet njohin, pranojnë e vërtetojnë se me nënshkrimin e kësaj Akt-Marreveshjeje heqin dorë shprehimisht nga çdo e drejtë, pretendim, kerkese dhe/ose padi ne lidhje me çdo parashikim të Kontrates perfshire por pa u kufizuar ne parashikimet ne lidhje me të drejtat dhe detyrimet per demshperblime, pagesat etj.
4. Palet çlirojnë reciprokisht njera-tjetren nga çdo detyrim që mund të mos jete permbushur sipas Kontrates dhe gjithashtu heqin dorë nga çdo mjet ligjor kunder njera-tjetres ne lidhje me Kontraten.
5. Perfundimisht Palet bien dakord që me lidhjen e kësaj Marreveshje Neritan Kadhe dhe Martin Aliko largohen nga shoqëria "Tirana Turizem" shpk dhe ortak i vetem i shoqërisë është z. Aleksander Ganolli. Palet bien dakord që kjo Marreveshje të regjistrohet ne Regjistrin Tregtar duke pasqyruar edhe ndryshimin e struktures se zoterimit te kapitalit te shoqerise.
6. Kjo Akt-Marreveshje është hartuar ne baze te legjislacionit shqiptar dhe konkretisht te Kodit Civil te Republikës së Shqipërisë.

Kjo Akt-Marrëveshje u hartua sipas kërkesës së paleve në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën Shqipe dhe pasi iu lexua Palëve me zë të lartë e të qartë, nga unë Noteri, dhe u gjet në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u nënshkrua rregullisht prej Palëve në praninë time dhe unë, Noteri, e vërtetoj sipas ligjit dhe për gjithë efektet e tij.

SHITËSI

Aleksander Ganolli

BLERËSI

Martin Aliko

Neritan Kadhe

NERITAN KADHE

NOTERI

JULIAN ZHELEGU



VENDIM
I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE
“Tirana Turizem” shpk.

Sot, me date 28.5.2021, Asambleja e Ortakeve te shoqerise “Tirana Turizem” Sh.P.K. (ne vijim “Shoqëria”), shoqëri tregtare me përgjegjësi te kufizuar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare te Regjistrimit me Numër Unik Identifikimi NUIS L81529022E, mblidhet rregullisht per te diskutuar sa me poshte:

Rendi i dites eshte:

- 1) *Miratimi i zgjidhjes se Kontrates se Shitjes se Kuotes se lidhur ndërmjet Aleksander Ganolli (shitës) dhe Martin Aliko e Neritan Kadhe (blerës) dhe kthimit te paleve ne gjendjen e mëparshme;*
- 2) *Te tjera eventuale;*

Në bazë të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”, dhe në bazë të Statutit të Shoqërisë, asambleja e ortakeve:

VENDOSI:

1. Te miratoje zgjidhjen e kontratës se shitjes se kuotës me nr. 1233 rep, nr. 356 kol, date 12.2.2021 te Noter Julian Zhelegu, te lidhur ndërmjet shitësit Aleksander Ganolli dhe blerësve Martin Aliko dhe Neritan Kadhe. Te autorizojë regjistrimin e marrëveshjes per zgjidhjen e kontratës se sipërpërmendur dhe kthimin e paleve ne gjendjen e mëparshme. Me lidhjen e kontratës dhe ne baze te këtij vendimi, ortakët Martin Aliko dhe Neritan Kadhe do te largohen nga shoqëria dhe ortak i vetem i shoqerise do te mbetet z. Aleksander Ganolli.
2. Administrator i vetem i shoqerise vijon te mbetet z. Aleksander Ganolli, i cili ngarkohet me depozitim per regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me kërkesat e Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe Ligjit “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE
“Tirana Turizem” shpk.

Neritan Kadhe

Martin Aliko





**REPUBLIKA E SHQIPËRIË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

DEGA VENDORE TIRANË

**NOTER JULIAN ZHELEGU
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr.
Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr.
2
TEL: 0682027818**

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1233

Nr. koleksioni: 356

Tirane më 12/02/2021

Ligjet referuese:

1. Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
2. Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
3. Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

* Akti noterial përbëhet nga 4 fletë



A2021053950036116262



A2021053950036116262

KONTRATE SHITJE KUOTE

Sot, ~~me~~ ^{me} datë 02.2021, para meje Noter **JULIAN ZHELEGU**, anëtar në ~~Dhomën~~ Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr. 2, u paraqit personalisht:

SHITES:

Aleksander Ganolli, atësia Robert, amësia Valbona, shtetas Shqiptar, lindur në Miras, Devoll dhe banues në Tiranë, me adresë Dervish Hima; Nd. 10; H. 6; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; 0000; Tiranë, lindur më 18/08/1997, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032757134 dhe nr. personal J708180330, .

(këtu e më poshtë për efektet e kësaj kontrate, cilësuar si Shitës).

BLERES:

Martin Allko, atësia Fiqri, amësia Margarita, shtetas Shqiptar, lindur në Gjirokastrë dhe banues në Gjirokastrë, me adresë L 11 Janari; Nd. 090; Gjirokastrë; Gjirokastrë; 6001; Gjirokastrë, lindur më 02/08/1980, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 028371207 dhe nr. personal I00802078R,

Neritan Kadhe, atësia Tomor, amësia Vitori, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në Korçë, me adresë L.17 Rr. Bajazit Rehova; Nd. Nr.4; Korçë; Korçë; 7001; Korçë, lindur më 31/01/1982, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036170149 dhe nr. personal I20131080R, .

(këtu e më poshtë për efektet e kësaj kontrate, cilësuar si Blerës).

Palët e mësipërme ne vijim dhe për efekt të kësaj Kontrate, do të referohen individualisht si "Pale/a" dhe së bashku si "Pale/et".

MEQENESE:

- Shitësi është ortak zotërues i 100% (njëqind për qind) të kuotave të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "Tirana Turizem" shpk. (ne vijim "Shoqëria"), shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar e që funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me Numër Unik Identifikimi NUIS L81529022E dhe me seli në Tirane, Njesia Administrative nr. 5, Rruga Pjeter Bogdani, nr. 5, kapitali themeltar i regjistruar i të cilës është në shumën ALL 100.000 (njëqind mijë Lekë), sikurse rezulton nga Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
- Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit 100% (njëqind për qind) të kapitalit të Shoqërisë (ne vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Kuota") dhe Blerësi dëshiron të blejë (secili prej blerësve barazisht) Kuotën.
- Kalimi i Kuotës sipas kësaj Kontrate është miratuar me vendimin bashkëlidhur të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë.
- Nga verifikimi i Regjistrimit të Barreve Siguresë, Kuota rezulton të jete e lire dhe e pa barrësuar.

PER SA ME SIPER, Palët ranë dakord për të lidhur këtë Kontratë Shitje Kuote.



A2021053950036116262

- 1.1. Objekti i kësaj kontrate është kalimi i pronësisë së Kuotës nga Shitësi te Blerësi dhe fitimi i pronësisë mbi Kuotën që përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë nga Blerësi, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Kontratë.
- 1.2. Me lidhjen e kësaj Kontrate pronësia mbi Kuotën kalon nga Shitësi te Blerësi ku secili prej blerësve fiton pronësinë mbi 100% (njëqind përqind) të kapitalit.

NENI 2

ÇMIMI DHE MENYRA E PAGESES

- 2.1. Çmimi i shitjes së Kuotës që përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë është EUR 33.000 (tridhjetë e tre mijë Euro), i pagueshëm si vijon:
 - Brenda 5 (pese) ditëve kalendarike nga dita e lidhjes së kontratës paguhet kësti i parë i çmimit të shitjes në vlerën prej EUR 11.000 (njëmbëdhjetë mijë Euro) me para në dorë dhe/ose në llogarinë bankare të Shitësit pranë Bankës Intesa Sanpaolo Bank me IBAN AL81208111010000093865338001.
 - Brenda datës 15.7.2021 (pesëmbëdhjetë korrik dy mijë e njëzet e një) paguhet kësti i dytë i çmimit të shitjes në vlerën prej EUR 11.000 (njëmbëdhjetë mijë Euro) me para në dorë dhe/ose në llogarinë bankare të Shitësit pranë Bankës Intesa Sanpaolo Bank me IBAN AL81208111010000093865338001.
 - Brenda datës 15.2.2022 (pesëmbëdhjetë shkurt dymijë e njëzet e dy) paguhet kësti i tretë i çmimit të shitjes në vlerën prej EUR 11.000 (njëmbëdhjetë mijë Euro) me para në dorë dhe/ose në llogarinë bankare të Shitësit pranë Bankës Intesa Sanpaolo Bank me IBAN AL81208111010000093865338001.Mandatet bankare të pagesave do të përbëjnë prove të plote të shlyerjes së çmimit të shitjes dhe do t'i bashkëlidhen kësaj Kontrate.
- 2.2. Çmimi i shitjes gjendet i drejtë dhe i arsyeshëm dhe Palët garantojnë se me nënshkrimin e kësaj Kontrate nuk do të kenë asnjë pretendim të çfarëdolloji në lidhje me çmimin e shitjes.

NENI 3

KALIMI I PRONËSISË MBI KUOTEN

- 3.1. Pronësia mbi Kuotën që përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë do të kalojë nga Shitësi te Blerësi menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate, e cila do të regjistrohet menjëherë në librat e Shoqërisë si dhe në Regjistrin Tregtar sipas ligjit. Kuota do të mbetet e barrësuar me barre siguroese në favor të Shitësit dhe në përputhje me kontratën e barrës siguroese që do të lidhin Palët për garantimin e shlyerjes së çmimit të shitjes sipas kësaj Kontrate.
- 3.2. Palët konfirmojnë se struktura e zotërimit të kapitalit të Shoqërisë, me lidhjen e kësaj Kontrate, do të jetë si vijon:
 - z. Martin Aliko zoterues i 1 kuote që përfaqëson 50 % të kapitalit;
 - z. Neritan Kadhe zoterues i 1 kuote që përfaqëson 50 % të kapitalit;
 - z. Aleksander Ganolli largohet nga Shoqëria.

NENI 4

DEKLARATA DHE GARANCI

- 4.1. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se:
 - a. Shitësi është zotëruesi i vetëm i Kuotës së Shoqërisë dhe ai gëzon gjithë të drejtat e votës dhe çdo të



A2021053950036116262



- drejte tjetër që rrjedh nga Kuota dhe kësaj Kuota për të shitur Kuotën e zotëruar prej tij.
- b. Kuota është nënshkruar dhe paguar plotësisht.
 - c. Kuota e zotëruar nga Shitësi është lirish e transferueshme dhe asnjë miratim tjetër nuk nevojitet për realizimin e kalimit të pronësisë mbi Kuotën sipas kësaj Kontrate. Shitësi i jep Blerësit garancitë më të plota të evikcionit dhe garanton se në rast se ndonjë palë e tretë do të ngrejë pretendime në lidhje me të drejta mbi Kuotën, Shitësi do të garantojë që pronësia e Blerësit mbi Kuotën të mos cenohet në asnjë mënyrë a masë.
 - d. Kuota është e lirë nga çdo lloj pengu, detyrimi, takse, pretendimi, të drejte parablerjeje, apo barre tjetër dhe asnjë person i tretë nuk ka asnjë të drejtë reale apo garancie mbi Kuotën. Shitësi ka të drejte të shesë dhe t'ia transferojë Kuotën Blerësit sipas kësaj Kontrate. Blerësi fiton të drejtat e plota e të pakufizuara të pronësisë mbi Kuotën sipas kësaj Kontrate.
 - e. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Shitësi, nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumentet e tjera ligjore në të cilat Shitësi është palë.
 - f. Me lidhjen e kësaj Kontrate, Shitësi garanton Blerësin se do t'i sigurojë atij kontrollin efektiv të Shoqërisë në përputhje me të drejtat që rezultojnë nga zotërimi i Kuotës.
 - g. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se deklarimet dhe garancitë e dhëna sipas kësaj Kontrate janë të vërteta, të sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit.

4.2. Blerësi deklaron dhe garanton Shitësin se:

- a. Blerësi ka tagra të plota për të blerë Kuotën sipas kushteve dhe afateve të kësaj Kontrate.
- b. Blerësi do të paguaje tërësisht çmimin e shitjes sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate.
- c. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Blerësi, nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumentet e tjera ligjore në të cilat Blerësi është palë.
- d. Blerësi deklaron dhe garanton Shitësit se deklarimet dhe garancitë e dhëna sipas kësaj Kontrate janë të vërteta, të sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit.

4.3. Palët konfirmojnë se detyrimi i Blerësit për pagimin e çmimit të shitjes është përmbushur përpara lidhjes së Kontratës.

**Neni 5
DISPOZITA TË FUNDIT**

- 5.1. Kjo Kontrate hyn në fuqi me nënshkrimin e saj.
- 5.2. Çdo kusht, klauzole apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzolave apo parashikimeve të tjera dhe vlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi nuk do të çenohet nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër.
- 5.3. Kjo Kontrate përmban marrëveshjen e plote ndërmjet palëve në lidhje me objektin e përcaktuar këtu dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme, me gojë apo me shkrim, ndërmjet Palëve, në lidhje me objektin e kësaj Kontrate.
- 5.4. Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, dhe nenet 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
- 5.5. Çdo konflikt apo mosmarrëveshje që lidhet me hartimin, interpretimin apo zbatimin e kësaj Kontrate, që nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet Palëve, do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kontratës i bashkëlidhen kopje të dokumenteve të identifikimit dhe përfaqësimit të Palëve dhe Aneksi A (Ekstrakt nga Regjistri Tregtar i Shoqërisë) dhe Aneksi B (Ekstrakt nga Regjistri i Barrëve Siguruese) dhe Aneksi C (Vendimi i Ortakut të Vetëm të Shoqërisë për miratimin e transferimit të Kuotës).


Fq. 3





A2021053950036116262

Unë Noteri e hartova këtë Kontratë sipas kërkesës së Palëve në gjuhën Shqipe dhe në katër origjinale e pasi ua lexova me zë të lartë e të qartë, u gjet në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, të shprehur përpara meje, nënshkruhet prej tyre rregullisht në praninë time dhe unë e vërtetoj sipas ligjit dhe për të gjithë pasojat e tij.

SHITËSI
Aleksander Ganoll

Aleksander
Ganoll: 

BLERËSI
Martin Aliko

Martin Aliko

Neritan Kadhe


NOTERI
Jullan Zhelegu

